



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.  
3.8.2021

Tiranë,

**Lënda:** Përgjigje pyetjeve të parashtruara nga trupi gjykues në seancën e datës 3.8.2021.

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përgjigje të pyetjeve të ngritura në seancën e sotme gjyqësore të datës 3.8.2021, lidhur me korrespondencën e ndjekur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me kompaninë "Vodafone Albania", administruar në cilësinë e provës nga Kolegji, Komisioneri Publik mban qëndrimin si vijon:

1. Në lidhje me pyetjen e trupit gjykues nëse Komisioneri Publik në kohën e ushtrimit të ankimit kundër vendimit nr. 200/2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka disponuar nga ky i fundit të dhënat e ardhura në formatin CD, administruar prej Kolegjit me shkresën e datës 30.7.2021, parashtrorë se ankimi i Komisionerit Publik është bazuar në aktet e dërguara nga Komisioni, administruar prej tij si provë gjatë hetimit administrativ, njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 05.12.2019, protokolluar me nr. \*\*\* prot..

1.1 Theksojmë se Komisioneri Publik në ushtrimin e të drejtës së ankimit është bazuar njëkohësisht në përmbajtjen e akteve të njoftuara nga Komisioni dhe përmbajtjen e rekomandimit të një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtar të ONM-së, nr. 1327/1, datë 4.12.2019 (f. 5, prg. i fundit). Përmbajtja e këtij rekomandimi, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtar të ONM-së, në referencë të pikës 3, germa

“c”, të nenit B, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, është bashkëlidhur dhe është pjesë e ankimit të Komisionerit Publik.

1.2 Përmbajtja dhe vërtetësia e informacionit mbi komunikimin e subjektit të rivlerësimit me shtetasin \*\*\*, sikurse rezulton nga aktet e përcjella rishtazi gjatë këtij gjykimi, referuar korrespondencës së ndjekur nga Komisioni me kompaninë “Vodafone Albania”, tashmë administruar në cilësinë e provës nga ana e Kolegjit, janë pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të shkaqeve të ankimit dhe bisedimeve përfundimtare në këtë gjykim, ka dhënë shpjegime përkatëse për ti prapësuar ato.

2. Në lidhje me pyetjen e ngritur nga përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik, pa dashur të kalojë në përsëritje, ndan të njëjtin qëndrim si më sipër trajtuar.

3. Bazuar në përgjigjen më lart, Komisioneri Publik thekson se në qëndrimin e tij i referohet numrit të poseduar nga subjekti i rivlerësimit, i cili përfundon me shifrat \*\*\* \*\*\*, deklaruar prej tij në deklaratën interesave private periodike/vjetor për vitin 2016. Gjithashtu edhe numri tjetër që mbaron me \*\*\* përkundër nga sa u pretendua ka qenë në posedim të subjektit, deklaruar prej tij në të njëjtën deklaratë, numër ky i cili më pas në kohë, rezulton i regjistruar në emër të shtetases \*\*\* sipas shkresës me referencë \*\*\* të “Vodafone Albania”.

4. Për identifikimin e numrit të shtetasit \*\*\* Komisioneri Publik nuk i referohet një denoncimi anonim por akteve procedurale të administruara gjatë zhvillimit të procedimit penal me nr. \*\*\* /2010, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kurbin (procesverbal për kallëzimin e veprës penale datë \*\*\*.5.2010, akt i mbajtur nga personeli i kësaj prokurorie).

5. Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik i qëndron të gjitha shkaqeve të ankimit dhe kërkimit të bisedimeve përfundimtare të datës 16.7.2021, duke u shprehur se nuk ka gjë tjetër për të shtuar.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Dariel Sina**

